



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 18
Prishtinë, më 16 maj 2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Verica Çeraniq, Muharrem Nitaj, Shqipe Pantina, Avdullah Hoti dhe Albert Kinolli.

Munguan: Faton Topalli, Andin Hoti, Zafir Berisha dhe Ali Lajçi.

Pjesëmarrësit tjerë: Vlora Spanca, Shkëlqim Xhema nga ZKA-ja; Mentor Hyseni nga GIZ; Donika Osmani nga Ekonomia Online; Pajtim Quni, RTK..

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 2.5.2018;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve nga raporti i auditimit për efikasitetin e menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve nga raporti të auditimit Efektiviteti i Sistemit Informativ të Tatimit në Pronë;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 2.5.2018;

Verica Caraniq: Për arsye të mospërkthimit të procesverbalit në gjuhën serbe, unë propozoj që të mos miratohet deri sa të përkthehet.

Përfundimi

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 2.5.2018, nuk u miratua, është shtyre për mbledhjen e radhës së Komisionit.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve nga raporti i auditimit për efikasitetin e menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore;

Kryetari, paraqiti para deputeteve dy lloj rekomandime; ato të propozuara nga deputeti Avdullah Hoti dhe ato nga administrata e komisionit. Në rekomandimet e deputetit Hoti, ku thuhet: Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Gjykatat Themelore të përfshira në auditim, brenda një muaji, të hartojnë planin e veprimit për adresimin e të gjeturave të auditorit, i cili plan duhet të përmbajë në veçanti institucionet/zyrtarët përgjegjës dhe afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të auditorit, dhe këtë ta dorëzojë në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit edhe atë: KGJK-ja të trajnojnë personelin e gjykatës që merren me pranimin dhe regjistrimin e lëndëve (përfshirë edhe sekretarët juridikë, që mbështesin punën e gjyqtarëve), me fokus të veçantë përgatitjen e tyre rreth direktivave që duhen ndjekur për të konstatuar kompletimin dhe precizimin e kërkesë padive.

KGJK-ja të analizojë me kujdes rekomandimet e dhëna nga Njësia për Shqyrtimin e Performancës së Gjyqësorit (si mekanizëm mbikëqyrës i vet Këshillit) dhe të funksionalizojë dhe marrë për bazë ato rekomandime që konsiderohen se përmirësojnë procesin e menaxhimit të lëndëve civile në Gjykata. Gjykatat Themelore të monitorojnë performancën e menaxhimit të lëndëve civile për secilin gjyqtarë dhe për secilën lëndë që ata zgjidhin, si dhe të shikohen praktikat që janë aplikuar dhe burimet që kanë qenë në dispozicion për të zgjidhur lëndët. Gjykatat Themelore të standardizojnë procedurën e shpërndarjes së lëndëve përmes shortit dhe të evitojnë shpërndarjen e lëndëve përmes metodës së rotacionit. Gjykatat Themelore të sistemojnë pranimin e lëndëve civile në një bazë të unifikuar dhe elektronike të të dhënave, e cila do të përmbante informacione kryesore dhe përmbledhëse. Gjykatat Themelore të shqyrtojnë lëndët civile në mënyrë të balancuar, duke nënkuptuar që prioriteti i ekuilibruar i jepet të gjitha kategorive të lëndëve, duke filluar nga ato që janë transferuar nga vitet e mëparshme, lëndët që tashmë u është dhënë prioritet nga rregulloret e ndryshme dhe lëndët që janë kthyer në rigjykim. Dhe rekomandimi i fundit është që Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, pas pranimit të planit sipas pikës së parë, do të shqyrtojë atë dhe do t'ia përcjell seancës për informim, së bashku me raportin e Auditimit.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që raporti i Auditimit për efikasitetin e menaxhimit të lëndëve civile në Gjykatat Themelore, të mos adresohet për séance plenare derisa të hartohet plani i veprimit nga KGJK –ja për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga KMFP-ja.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve nga raporti të auditimit Efektiviteti i Sistemit Informativ të Tatimit në Pronë;

Kryetari, njoftoi deputetët se administrata ka përgatitur rekomandimet për Ministrinë e Financave, të cilat janë: Ministria e Financave (MF) duhet të hartojë planin e veprimit për të gjeturat e auditorit, duke caktuar personat përgjegjës dhe afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditorit të jashtëm, për „efektivitetin e sistemit informativ të Tatimit në Pronë. Për këtë brenda një muaji ta njoftojë Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike, në veçanti për: MF-në të sigurohet që janë duke u përmbushur zotimet e bëra me marrëveshje për plotësimin e personelit, sigurimin e infrastrukturës si dhe zotimet e tjera të marrëveshjeve të realizuar në mes të MF-së, Agjencisë Suedeze të Tatimeve (ATS-së) dhe MF-së me SIDA-ën, dhe rekomandimi i fundit ishte që MF-ja të zhvillojë strategji dhe plane për përfshirjen e katër komunave për mbledhjen e të hyrave nga tatimi në pronë si dhe shfrytëzimin e sistemit për menaxhimin e të dhënave të tatimit në pronë.

Verica Caraniq, propozoi që pika (b) e rekomandimeve të propozuara nga kryetari i Komisionit dhe nga administrata, të riformulohet, apo të fshihet si rekomandim, përndryshe do të abstenojë.

Kryetari, e hodhi në votim propozimin e deputetes Varica Caraniq, për riformulimin e pikës b të rekomandimit, për të cilin ndryshim u pajtuan edhe anëtarët tjerë të komisionit.

Përfundim

KMFP-ja vendosi që raporti i Auditimit për Efektivitetin e Sistemit Informativ të Tatimit në Pronë, të mos adresohet për Seancë Plenare, por rekomandimet ti adresohen vetëm Ministrisë së Financave.

5. Të ndryshme.

Driton Selmanaj, kryetari, njoftoi deputetët se komisioni ka pranuar raportin e performancës së ZKA-së për vitin 2017, pa PVF-të e Audituar nga kompania audituese që e ka zgjedh Kuvendi dhe propozoi që ky raport të shqyrtohet nga mesi i muajit qershor të vitit 2018.

Avdullah Hoti, theksoi se ky raport është për punën e vetë ZKA-së, së bashku me pasqyrat financiare të vetë Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Shqipe Pantina, tha se është mirë të presim deri sa të vinë PVF të auditura nga dhe pastaj ta shqyrtojmë raportin e ZKA-së.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që Raporti i Performancës për ZKA-në të shqyrtohet pasi të pranohen PVF-të e Audituar nga kompania audituese e angazhuar nga Kuvendi.

Driton Selmanaj, kryetar, njoftoi deputetët se administrata e komisionit ka përgatitur listën e raporteve të auditimit, të cilat deri tani janë dorëzuar në KMFP, andaj për mbledhjen e radhës ai propozoi të shqyrtohet raporti për OSHP-të, AAC-në dhe raporti i performancës për E-Pasurinë. Deputeti Andin Hoti do të jetë raportues për OSHP-të, Mërgim Lushtaku për AAC-në dhe Avdullah Hoti për raportin e E-Pasurisë, raporte këto që do të shqyrtohen në mbledhjen e radhës së Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Driton Selmanaj